



Trekëndëshi jo funksional

(Marrëdhëniet ndërmjet Avokatit të Popullit,
Kuvendit të Kosovës dhe Shoqërisë Civile)

Ky projekt është përkrahur nga
Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile(KCSF)



Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile
Kosovar Civil Society Foundation



Hyrje.....	5
Avokati i Popullit në zyrë, më pak në terren.....	6
Raporti i Avokatit të Popullit me institucionet.....	7
Avokati i Popullit versus Kuvendi i Kosovës.....	7
Raporti i Avokatit të Popullit me gjykatat.....	8
Komunat, me (pa) Avokatin e Popullit.....	9
Shoqëria civile “avokate” e Avokatit të Popullit.....	10
Avokati i Popullit pa mediat / mediat pas Avokatit.....	10
Raporti i Progresit - sfidat e Avokatit.....	10
Rekomandimet:.....	11
Për Kuvendin e Kosovës.....	11
Për Institucionet e tjera (Komunat, gjykatat, policinë, OJQ-të).....	12
Për Institucionin e Avokatit të Popullit.....	13



Ne jemi një organizatë e pavarur me mandat të trajtimit të shkeljes së Drejtave të Njeriut dhe keqperdorimit të autoritetit nga Institucionet publike të Kosovës. Ne bëjmë hetime, lëshojmë raporte dhe sigurojmë shërbime ligjore dhe avokim publik.

Institucioni pranon dhe heton ankesat e çdo kujt në Kosovë, dhe të gjitha shërbimet tona sigurohen pa pagesë.

Avokati i Popullit, Sami Kurteshi



Hyrje

Institucioni i Avokatit të Popullit e përmbylli vitin 2010 me një sukses të cilit i parapriu shoqëria civile. Fitores së drejtësisë në rastin e “privilegjit të deputetëve” i ndihmoi edhe Avokati i Popullit kur udhëhoqi rastin në Gjykatën Kushtetuese. Ky institucion vendosi në fund të dhjetorit për pezullimin e ligjit për privilegjet e deputetëve. Sukses i përbashkët, megjithëse ky rast nuk mund ta amnistoj Institucionin e Avokatit të Popullit nga një vlerësim tjetër të punës përgjatë vitit 2010 që i bën ky raport.

Institucioni i Avokatit të Popullit (lexo: IAP) më shumë u shfaq në publik për publikmin e raportit të punës paraprake, pra të vitit 2009 se sa që njëmendë zhvilloi punë e hapi tema e çështje në vitin 2010. Nga monitorimi i aktiviteteve publike në media të Avokatit që i ka bërë Lëvizja FOL, rezulton se prej 80 artikujve, rreth 40 kanë të bëjnë me aktivitetet 2 javore të publikimit të raportit të punës të Avokatit për vitin 2009. Dhjetëra të tjerë nga tryezat e organizuara prej Lëvizjes FOL dhe aktivitete të tjera të pasqyruara në shkrimet autoriale të medias.

Me dhe pa aktivitetet publike të Avokatit të Popullit në 12 muajt e viti 2010, ky institucion më shumë u shfaq në zyrë se në terren. Ngeli duke u ankuar gjatë tërë vitit, ndërsa nuk mungoi solidariteti në distancë i institucioneve tjera me IAP-in. Alarmi për abuzimin e autoritetit publik dhe shkeljes së të drejtave të njeriut shpesh u dha nga mediat, se sa që vet Institucioni inicoi rastet në publik. Aty këtu u bë palë me mediat. Reagimi për mos lejimin e bartjes së mbulesës së nxënësve në shkolla nga ministria e Arsimit dhe për kthimin e ligjshmërisë në rastin e largimit të padrejtë të

shërbyesve civilë nga vendet e punës, janë disa nga çështjet e ndjeshme që avokoi Avokati i Popullit. Edhe pse kategori kushtetuese, kërkesat dhe rekomandimet e IAP-it rrallë u përmbushën, ndërsa këto raste dhe të tjera vazhdojnë të mos zgjidhen në favor të palëve të dëmtuara.

Pjesa e parë e vitit 2010 u karakterizua nga përpjekja e Avokatit të Popullit për miratimin e ligjit për Avokatin e Popullit nga Kuvendi i Kosovës, i cili si i tillë nuk është implementuar në tërësi. U ankua edhe për ndërhyrjen e politikës dhe dështimin e institucioneve tjera për ti zbatuar rekomandimet e Avokatit të Popullit. Debatin për punën dhe bashkëpunimin e këtij institucioni me aktorët e tjerë në vend e nxiti Lëvizja FOL. Tryezat në komuna të ndryshme, reagimet, intervistat ishin disa prej aktiviteteve që inicoi FOL në shërbim të fuqizimit të punës së IAP-it dhe kthimin e vëmendjes së të gjithëve se “ky institucion kushtetues meriton autoritetin dhe kredibilitetin që e kanë institucionet e ngjashme nëpër botë”.

Marrdhënia e Avokatit të Popullit me institucionet e tjera, puna në raport me shoqërinë civile, avokimi i të drejtave të njeriut dhe vlerësimi i raporteve ndërkombëtare, janë disa prej çështjeve bazë që trajton raporti i Lëvizjes FOL për bashkëpunimin ndërinstitucional dhe rolin e Avokatit të Popullit. Ky institucion trajtoi mijëra raste, lëshoi qindra kërkesa e vendime për çështjet nga më të ndryshmet. Mori në mbrojtje qytetarët e Kosovës pa dallim etnie e gjinie. Mbase nuk e paditi askënd, por u kërcënua me padi kreu i këtij institucioni, Sami Kurtesh.



Avokati i Popullit në zyrë, më pak në terren

Viktimat nga abuzimi i autoritetit publik në Kosovë rrallë e ndjenë dorën e Avokatit të Popullit. Edhe nëse u shfaq deklarativisht ta ofronte përkrahjen, pak u bë në respektimin e të drejtave të tyre. Me apo pa fajin e këtij institucioni, Avokati i Popullit dështoi ti përmbush detyrat kushtetuese. Arsyet janë të shumta, dhe jo të gjitha e kanë burimin tek ky institucion. Në raport me problemet e panumërta në këto dy çështjet e sipërpërmendura, IAP-i sipërfaqësisht u shfaq përgjatë vitit 2010 në trajtimin e tyre. Pjesa e parë e vitit e gjeti këtë institucion duke ankuar për "mos vëmendjen e duhur të institucioneve karshi Avokatit të Popullit".

"Rënia e kredibilitetit, moszbatimi i rekomandimeve nga institucionet e tjera, kapacitetet e limituara, zvarritja e ligjit, injorimi i kuvendit"¹, evitendohen si disa prej sfidave që e kanë përcjell këtë institucion dhe si të tilla ndikuan negativisht në mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Vërejtjet dhe kërkesat e IAP për përmirësimin e projektligjit për Avokatin e Popullit konsistonin në "parashikimin e sanksioneve ndaj institucioneve që nuk i marrin parasysh rekomandimet e avokatit apo vendimet e tij".

Dështimi i funksionimit të hallkës së komunikimi ndërinstytucional, veçmas me gjykatat, ka ndikuar edhe në mos përmbushjen e obligimeve kushtetuese të Avokatit të Popullit. "Moszbatimi i vendimeve gjyqësore është ndër shkaktarët kryesorë të shkeljes së të drejtave të njeriut. Ky fenomen e zhbën besimin e qytetarëve në sistemin gjyqësor"²

Moszbatueshmëria e vendimeve të gjykatave dhe cënimi i sundimit të ligjit, dëmtojnë besimin tek Avokati i Popullit në kryerjen e detyrave të përcaktuara, ndërsa mos zgjedhja e zëvendësve, mungesa e stafit dhe e buxhetit, janë

disa nga problemet tjera që i shtohen listës së gjatë të mungesave që e karakterizoi institucionin gjatë vitit 2010. Dështimi i Kuvendit të Kosovës për ta zgjedhur Avokatin e Popullit për disa vite i kushtoi kredibilitetit të këtij institucioni, i cili megjithatë shënoi disa nga sukseset, që sipas zyrtarëve të tij janë "rritja e numrit të ankesave të qytetarëve dhe disponimi i mirë i institucioneve tjera për ti kthyer përgjigje Avokatit të Popullit". Edhe pse rrallë dihet epilogu përfundimtar i këtyre ankesave, ngritja e vetëdijes qytetare për t'u ankuar tek një institucion suprem i të drejtave të njeriut, përbën lajmin e mirë.

Sfidat e këtij institucioni u përmendën në fillim të vitit 2010 edhe prej disa udhëheqësve të institucioneve tjera, si KMDLN-ja, e cila vlerësoi se "ky institucion është i destinuar të mos fuqizohet për shkak të ndikimeve të organeve tjera të pushtetit". Edhe aktorë të tjerë relevantë shoqërorë e vlerësuan të vështirë punën në vitin 2010 të Avokatit për shkak të ndikimit edhe të politikës vendore e ndërkombëtare duke konkluduar se "ai do të mbetet një institucion që rri në zyrë duke dërguar letra dhe po në zyrë i pranon ato - me efektin minimal në mbrojtjen e të drejtave të njeriut"³. Avokati i Popullit nisi dhe përmbylli vitin kalendarik të punës duke ankuar në fillim për "mos miratimin e ligjit dhe në fund tek institucionet e shumta, si gjykatat, se po injoronin kërkesat dhe rekomandimet e Avokatit të Popullit". Kreu i këtij institucioni zhvilloi disa takime me kryetar komunash, me figura tjera në Prishtinë, mori pjesë në Ditët e Avokatit të Popullit, por pjesën e mbetur të ditëve të vitit kalendarik e kaloi me zyrë duke pritur e shqyrtuar ankesat e qytetarëve.



Raporti i Avokatit të Popullit me institucionet

Institucioni i Avokatit të Popullit bëri përpjekje të kënaqshme gjatë vitit të vendos bashkëpunim me institucionet e tjera. U prit dhe u përcoll nga zyra të shumta, por kërkesat dhe rekomandimet e tij pak u morën parasysh nga përfaqësuesit e këtyre zyrave.

Partneriteti më i mirë që u vendos ishte me shoqërinë civile, pas iniciativës së kësaj të fundit për të vendosur bashkëpunimin, ndërsa mediat përgjithësisht raportuan pozitivisht. Arritja më e madhe e bashkëpunimit me shoqërinë civile u kurorëzua në ditët e fundit të dhjetorit 2010, një aktivitet që kishte nisur në fillim të nëntorit. Gjykata Kushtetuese vendosi të pezulloj ligjin për privilegjet e deputetëve, pasi kjo çështje u ngrit me shumë zhurmë nga shoqëria civile ndërsa rasti arriti në Kushtetuese përmes Avokatit të Popullit.

Lëvizja FOL ka monitoruar përgjatë vitit aktivitetet e Avokatit të Popullit në zyrë dhe jashtë, ndërsa media jo çdo herë raportoi tërë punën e institucionit. Aktivitetet e avokatit u pasqyruan në të shumtën e rasteve nga ngjarjet që i paraprinë reagimit të Avokatit të Popullit dhe inicimit të temave nga aktorë të tjerë, se sa që ky institucion e bëri këtë qëllimshëm. Kjo absolutisht nuk nënkupton mos punën, por defektin në organizimin e punëve të këtij institucioni.

Ekziston përshtypja se reagimi i Avokatit të Popullit shpesh ndodh për hir të reagimit, ndërsa ideja e ekzistimit të tij përkthehet me nevojën që çdo demokraci e re duhet ta ketë këtë institucion. Kjo është praktikë në vendet e tjera, dhe Kosova nuk mund të jetë përjashtimi.⁵ Disa prej problemeve që provokuan reagimin e Institucionit të Avokatit të Popullit, jo vetëm që nuk morrën

vëmendjen e duhur, por ato u thelluan edhe më shumë. Njëri prej shembujve janë shkyqjet kolektive të KEK-ut. Në shkurt të vitit 2010, Avokati reagoi ndaj shkyqjeve kolektive nga rrjeti i energjisë elektrike, duke e konsideruar shkelje të të drejtave të njeriut.⁶ Këta zëra jo vetëm që u injoruan, por në nëntor dhe dhjetor të 2010-s, shkyqjet morën përmasa të mëdha. Reagimi mungoi, dhe ky është një defekt tjetër i Avokatit që nuk e përcjell në mënyrë lineare një çështje, veçmas të ngritur më herët..

Avokati i Popullit versus Kuvendi i Kosovës

Njëri prej institucioneve që do të duhej ta mbështeste punën e Avokatit të Popullit, e rregulluar me Kushtetutën e vendit, nuk është marr edhe aq shumë me këtë institucion.

Në agjendën e legjislativit për vitin 2010, deputetët pak kohë i rezervuan punës dhe aktivitetet e Avokatit.

Pjesa e parë e vitit kaloi në shenjë të miratimit të ligjit për Avokatin e Popullit, prezantimit të raportit të punës për vitin 2009 të IAP në Kuvendin e Kosovës, dhe aty këtu ndonjë aktivitet komisioni parlamentar, si në rastet e seancave të dëgjimeve publike.

Gjatë punimeve të komisionit për legjisllacion në rastin e projektligjit për Avokatin, më shumë është imponuar dëshira individuale e deputetëve se sa rekomandimet e shoqërisë civile dhe vet IAP-it.⁶ Rekomandimet kanë qenë pothuasje të njëjta me ato të Avokatit të Popullit. (Shembull: Projektigji i Avokatit thirrej në ligjet për pagat e zyrtarëve publikë, ndërsa në atë kohë ky ligj as që ishte miratuar duke dëshmuar një mos harmonizim të duhur mër miratimin e këtij ligji).



Disa komisione parlamentare në pjesën e dytë të vitit 2010 u mbledhën për të përmirësuar vërejtjet e Raportit të Progresit për vitin 2009 në lidhje me IAP-in, megjithatë pos zotimeve në letër asgjë nuk u përmirësua. Kjo mbështetet në faktin se të njëjtat vërejtje të Bashkimit Evropian të 2009 janë përcjell edhe në Raportin e Progresit të një viti më pas. Shembull tjetër janë diskutimet për raportin punës të IAP-it.⁷ Prezantimi i raportit në Kuvendin e Kosovës kaloi pa ndonjë debat të mirëfilltë. Ndërsa në të njëjtën ditë ky raport u prezantua edhe në tryezën e organizuar nga Lëvizja FOL, ku diskutimi ishte shumë më i thellë dhe më përmbajtjesor se në Kuvendin i Kosovës.

Shto kësaj faktin se rekomandimet e prezantuara nga raporti i IAP-it nuk janë inkorporuar në strategjinë e punës së Kuvendit të Kosovës. Madje Kuvendi i Kosovës as që është munduar të ndër marrë ndonjë nismë që të gjeturat nga raporti të diskutohen dhe të kërkohet nga institucionet të marrin masa apo që edhe vet Kuvendi të marrë masat që janë në përgjegjësi të tij.

Mbështetja deklarative e krerëve të Kuvendit të Kosovës dhe deputetëve individualisht nuk ka munguar. Përtej obligimit të tyre kushtetues për ta forcuar punën e Avokatit të Popullit, ata në ndonjë paraqitje publike në media apo tryeza kanë folur në superlativ për Avokatin e Popullit. Në shënimin e dhjetëvjetorit të punës së Avokatit të Popullit, kryetari i Kuvendit të Kosovës, Jakup Krasniqi, pati thënë "se avokati mund të afirmoj punën që ta mbroj të drejtat e njeriut dhe personave juridikë nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të rregullta të organeve të administratës publike".⁸

Përtej deklaratave dashamirëse për Avokatin e Popullit, mbështetja për të, në praktikë ka munguar.

Raporti i Avokatit të Popullit me gjykatat

Marrëdhënia më e vështirë e bashkëpunimit të Institucionit të Avokatit të Popullit rezulton me gjykatat kosovare. Në çdo paraqitje publike dhe në raportet vjetore të këtij institucioni, përmenden marrëdhëniet jo të mira me gjykatat. Mungesa e bashkëpunimit përshkruhet në forma të ndryshme, prej mos kthimit të përgjigjeve ndaj kërkesave të Avokatit dhe numrit të madh të ankesave të qytetarve ndaj këtij institucioni. Prej 1300 rasteve të ankesave të qytetarëve të evidentuara në shtator të 2010, gjykatat prijnë për numrin më të madh të lëndëve dhe stërzgjatjes në zgjidhjen e tyre.⁹

Ky numër ka të bëjë me vonesën në zgjidhjen e lëndëve gjyqësore, ndërsa ky paraqet problem prej vitesh të gjykatave kosovare për grumbullimin e madh të lëndëve të pazgjidhura dhe kryesisht të mos funksionimit të administratës publike. Për fatin e keq të Avokatit, kërkesat dhe rekomandimet hasin në vesh të shurdhër. Për ta tejkaluar situatën, Avokati propozoi forma të tjera alternative, si themelimi i Gjykatës Administrative¹⁰, por pa sukses. Themelimi i Gjykatës Kushtetuese tërthorazi forcoi punën e Avokatit, për shkak të shumë rasteve të shkeljes së të drejtave të njeriut që ka trajtuar gjykata.

Njëri prej ish zyrtarëve të këtij institucioni, Hilmi Jashari (Shënim: I larguar në fund të vitit 2010 nga IAP-i. Lexo më poshtë)



ka përmendur shpesh herë ndikimin e politikës dhe problemin në moszbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit. “Sa herë që Avokati i Popullit e ngrit zërin për shkeljen e të drejtave të njeriut, pasojnë deklaratat nga qeveria, me të cilat sipas tij, pretendohet të amortizohen pohimet, duke dhënë arsytetime jokorrekte dhe të pasakta”¹¹. Vetë Jashari, në fund të vitit të kaluar, së bashku me një zyrtar tjetër të lartë është larguar nga Avokati i Popullit, duke shprehur pakënaqësinë me mënyrën si menagjohet institucioni nga Avokati Sami Kurteshi.

Komunat, me (pa) Avokatin e Popullit

Avokati i Popullit ka shtrirë pothuasje në tërë Kosovën veprimtarinë e tij përmes zyrave rajonale. Në Kosovë ka gjithësej 5 zyra rajonale, përjashto Prishtinën ku është e vendosur selia qendrore. Këto zyra kanë lehtësuar punën e Avokatit të Popullit në qendër, e më shumë të qytetarëve, të cilët ankesat e tyre i kanë drejtuar në komunat prej nga vijnë dhe jo në zyrën qendrore në Prishtinë. Numri i deponimit të ankesave ka ardhur në rritje, por ato shpesh nuk kanë marrë përgjigjen e duhur. Vendosja e komunikimit të Avokatit përmes zyrave me institucionet tjera, siç janë komunat, gjykatat komunale etj. ka qenë më i lehtë. Megjithatë, hulumtuesit nuk kanë vërejtur ndonjë ngritje cilësore të bashkëpunimit, në kuptimin që qytetarët të marrin përgjigje për ankesat e tyre, që institucionet e tjera publike dhe të pavarura të zbatojnë kërkesat e Avokatit të Popullit.

Lëvizja FOL gjatë vitit 2010 ka organizuar disa tryeza në komunat kryesore të Kosovës. Pjesa dërmuese e shqetësimeve të qytetarëve dhe institucioneve lokale mbetet e njëjta: ka të bëjë me mungesën e duhur të komunikimit ndër-institucional,

mos zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit. Në këtë raport, shembulli i debatit të organizuar në Prizren, reflekton qëndrimet e mësipërme.

Fillimisht drejtues të Gjykatës flasin për raporte të shkëllyera me Avokatin e Popullit pa folur konkretisht për çfarë lloj marrëdhëniesh. Marrë parasysh faktin që raportet vjetore të Avokatit të Popullit e konsiderojnë gjyqësorin ndërshkelësit më të mëdhenjë të të drejtave të njeriut në Kosovë. Drejtuesit e gjykatës më tej, ankohen në numrin e pakët të stafit dhe gjyqtarëve si dhe të infrastrukturës në trajtimin e të gjitha lëndëve, përfshirë edhe të atyre që vijnë nga Avokati i Popullit.

Përfaqësuesi i komunës ankohet në formatin e debatit dhe temës së përzgjedhur, duke injoruar pothuajse totalisht institucionet e tjera. Në fund, është Avokati i Popullit që ankohet për të gjithë për mos zbatueshmëri ligjesh nga të gjitha institucionet. Ky lloj komunikimi i disa zyrtarëve të institucioneve në një debat joformal flet më së miri për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit ndër-institucional. Edhe në Ferizaj gjendje pothuajse e njëjtë. Debati në këtë komunë i organizuar nga FOL nxjerr në pah gjykatat, policinë dhe komunën si institucionet më pak të përgjegjshme dhe shkelëse të të drejtave të njeriut.

Punonjës të Avokatit të Popullit kanë fare pak ndjeshmëri për idenë e zhvillimit të bashkëpunimit me institucionet e tjera, veçmas shoqërinë civile, ndërsa qytetarët nuk kanë njohuri të duhur për deponimin e ankesave, llojet e tyre dhe institucionet që duhet adresuar. Natyra e ankesave është më shumë e karakterit social si: punësimi, mos ofrimi i strehimit, shërbimit, çështjet e pronës, apo keqpërdorim i autoritetit nga zyrtarët komunalë.



Shoqëria civile “avokate” e Avokatit të Popullit

Avokati i Popullit po mbush dekadën e parë të punës pa vendur marrëdhënie të shëndosha të komunikimit me shoqërinë civile, njërin prej aleatëve të mundshëm në luftën e tij kundër abuzimit me autoritetin publik. Aktivitetet e para të organizuara në drejtim të sensibilizimit të rolit të këtij institucioni janë ndërmarrë gjatë vitit 2010 nga Lëvizja FOL përmes një sërë tryezash në nivel komunash, takimesh me grupe të interesit dhe konferenca të kohë paskohshme për ta përkrahur punën e Avokatit të Popullit. Në këto aktivitete është ngritur edhe çështja e komunikimit ndërinstytucional, në raport të Avokatit të Popullit me institucionet e tjera, si gjykatat, policia, e komunat.

Komunikimi ndërmjet institucioneve ekziston por ai mbetet jo funksional. Zyrtarët e IAP-it në të shumtën e rasteve mbesin pa përgjigje për kërkesat e tyre, ndërsa zgjidhje nuk gjejnë as kërkesat e qytetarëve. Hulumtuesit kanë vërjetur një mungesë vetëdijësimi të qytetarëve për tu ankuar për shkeljen e të drejtave të tyre. Avokati i Popullit nuk monitoron punën e kuvendeve komunale veçmas në miratimin e vendimeve, për të shikuar nëse po shkelen të drejtat e njeriut. OJQ-të lokale në përgjithësi nuk janë të njohura thellë me rolin e Avokatit të Popullit dhe punën e tij. Nuk është shënuar ndonjë përpjekje për të vendosur bashkëpunim konkret.

Avokati i Popullit pa mediat / mediat pas Avokatit

Avokati i zorit - është njëri prej titujve të paktë në media për Avokatin e Popullit. Sikur reflekton më së miri raportet e këtij institucioni me mediat. Në monitorimin e tërësishëm të aktiviteteve në media, Lëvizja FOL ka evidentuar shumë pak aktivitete të avokatit, aty këtu takime

me kryetar komunash, konferenca për raportet vjetore, tryeza të organizuara nga Lëvizja FOL dhe ndonjë temë gazetareske të inicuar nga mediat.

Web faqja e Avokatit pa informacione të bollshme, mungesë lajmesh nga aktivitetet e përditshme, jo lehtë e manovrueshme, janë disa prej pengesave kryesore në vendosjen e komunikimit të shëndoshë të këtij institucioni me mediat. Pa paragjykuar për aktivitetet, mos prezantimi i punëve në publik në këtë web faqe, e më pas edhe në media, është indikacion jo i mirë në vendosjen e bashkëpunimit me aleatin kryesor në luftën për mbrojtjen e të drejtave të njeriut - mediat. Në mediat e shkruara është më shumë prezent sesa në ato elektronike. Ndërsa shpesh herë është shfaqur në media me iniciativën e gazetarëve për temat e tyre, dhe jo që Avokati ka inicuar dhe udhëhequr agjendën e tij.

Raporti i Progresit - sfidat e Avokatit

Kosova dhe institucionet e saj sërish janë kritikuar në raportin e Progresit të vitit 2010. Madje edhe IAP-i, veçmas në aspektin e adresimit të shkeljes së të drejtave të njeriut dhe zvarritjes në përzgjedhjen e zëvendësve të Avokatit. Në pjesën për Demokracinë dhe Sundimin e Ligjit, raporti i Progresit përmend një sërë çështjesh që duhet adresuar. “Në korrik, Kosova ka miratuar ligjin për Avokatin e Popullit. Megjithatë, rekrutimi i zëvendësve në disa raste është shtyrë. Dobësimi i vazhdueshëm i institucionit të Avokatit duhet të adresohet. Autoritetet duhet të sigurojnë përgjigje të shpejta për të gjitha kërkesat dhe rekomandime të avokatit” thuhet në raport.¹²



Raporti më tej thekson “Vendimet e komisionit ndërministror duhet të formalizohen dhe të shpërndahen gjerësisht. Reformat duhet të jenë të buxhetuara, në konsultim të vazhdueshëm me ministrinë e Ekonomisë dhe Financave. Planet e zhvillimit strategjik duhet të implementohen në gjithë administratën e Kosovës.

Kapaciteti i departamentit për reformën e administratës publike dhe të departamentit për administrimin e shërbimit civil duhet të forcohet”.

Shqetësimet e Bashkimit Evropian pothuajse kanë qenë të ngjashme edhe në raportin e progresit të viti 2009. Madje këto çështje qenë diskutuar në disa takime të komisioneve parlamentare. Në korrik të 2010, Komisioni për Integritet Evropian, si dhe Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione, kanë mbajtur disa seanca të dëgjimit publik lidhur me përmbushjen e sfidave të dala nga Raporti i Progresit për Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe Avokatin e Popullit, në të cilën morën pjesë përfaqësues të MAPL-së, të Avokatit të Popullit, si dhe përfaqësues të OJQ-ve. Drejtues të këtyre organeve kanë premtuar përmbushjen e këtyre kërkesave përmes një plani të hartuar, por që rezulton të mbetet në letër edhe më tej.

Paditësi i Paditur

Avokati i Popullit, Sami Kurteshi, një vit pas ardhjes në krye të këtij institucioni u ballfaqua me një akuzë për parregullsi në mënyrën si është përzgjedhur. Paditësi i paditur - pasi ish kandidati për këtë post, Imer Ibriqaj, morri guximin të deponoj padi private në Gjykatën Supreme të Kosovës kundër Kuvendit të Kosovës dhe Kurteshit, me qëllim të vërtetimit nëse është shkelur Kushtetuta me rastin e përzgjedhjes së Avokatit të Popullit?

Rekomandimet:

Me pushtetin ende abuzohet në Kosovë. Shkilen të drejtat e njeriut, ndërsa Institucioni i Avokatit të Popullit mbetet i pafuqishëm përball këtyre zhvillimeve. Me qëllim të forcimit të punës së tij, vetëdijësimit të institucioneve tjera dhe zyrtarëve në respektimin e ligjeve, Lëvizja FOL nxjerr këto rekomandime si vijon:

Për Kuvendin e Kosovës

- Kuvendi i Kosovës duhet të konsultohet më shpesh me IAP-in për nevojat e tij, si dhe aktivitetet e tjera që i ndërmerr me qëllim të fuqizimit të punës së Avokatit të Popullit në mbrojtjen e të drejtave të njeriut;
- Kuvendi i Kosovës, marr parasysh agjendën e ngjeshur, do të duhej që në legjislativin e ri të formonte një komision ad hoc që do të merrej vetëm me zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit në mënyrë që ky institucion të forcoj autoritetin e tij, ashtu siç e parasheh Kushtetuta e Kosovës;
- Komisionet parlamentare, të fillojnë me zbatimin e menjëhershëm të rekomandimeve të Komisionit Evropian të evidentuara në të gjitha Raportet e Progresit, që kanë të bëjnë me punën e Avokatit të Popullit;
- Kuvendi i Kosovës, para miratimit të Buxhetit për vitin 2011, ti ndaj një buxhet më të favorshëm IAP-it, në mënyrë të rritjes së kapaciteteve



njerëzore, organizative dhe profesionale në adresimin e çështjeve që kanë të bëjnë me keqpërdorimin e pushtetit dhe shkeljes së të drejtave të njeriut;

- Deputetët e Kuvendit të Kosovës, veçmas ata të Komisionit parlamentar për të Drejtat e Njeriut, të mos presin agjendën e komisionit, raportimet e Avokatit të Popullit, por të iniciojnë debate në kuvend, të shtrojnë pyetje parlamentare duke u bërë pal me IAP-in në luftën kundër abuzimit me autoritetin publik.

Për Institucionet e tjera (Komunat, gjykatat, policinë, OJQ-të)

- Institucionet si komunat, gjykatat e policia, puna e të cilave është e ndërlidhur me IAP-in, duhet të marrin një rol më proaktiv në thellimin e bashkëpunimit. Nuk duhet pritur që format e bashkëpunimit të inicioj Avokati i Popullit apo shoqëria civile, por bashkëpunimi të shndërrohet në një kulturë të ndërsjell;
- Të zbatohen Kushtetuta e Kosovës dhe ligjet, që obligojnë institucionet në përmbushjen e rekomandimeve të dala nga IAP-i;
- Komunat, ashtu siç e parasheh ligji, ti obligojnë Koordinatorët komunalë për të drejtat e njeriut në koordinimin e aktiviteve, veçmas orientimin e rekomandimeve të IAP-it në zyrat përkatës komunale;
- Shoqëria civile, të udhëhiqet nga rasti i fundit i bashkëpunimit me IAP-in në privilegjet e deputetëve, për të ndërmarr iniciativa të ngjashme dhe të avokoj në të mirën e interesit publik;
- Komunat herë pas herë duhet të konsultohen me Avokatin e Popullit në nxjerrjen e vendimeve që prekin drejtpërdrejt të drejtat e njeriut dhe mirëqverisjen;
- Rekomandohet Zyra për Qeverisje të Mirë, pranë Kryeministrit, në ushtrimin e autoritetit të vet në dikasteret qeveritare që të respektojnë rekomandimet e IAP-it;
- Ministritë ti respektojnë rekomandimet e Institucionit të Avokatit të Popullit.



Për Institucionin e Avokatit të Popullit

- Avokati i Popullit të marrë një rol më proaktiv në të gjitha fushat që cenojnë liritë dhe të drejtat e njeriut. Aletatët e identifikuar si mediat dhe shoqërinë civile, ti afroj edhe më tej në krijimin e një fronti të përbashkët kundër abuzimit të autoritetit publik nga zyrtarët publik;
- IAP-i të ngrisë çështje në publik, atëherë kur ato nuk i zgjidh përmes rrugëve institucionale;
- Të filloj një fushatë sensibilizimi, jo vetëm me qëllim të vetëdijësimit qytetar për tu ankuar, por edhe të institucioneve në përmbushjen e përgjegjësive të tyre ligjore karshi IAP-it;
- Të forcoj zyrën për komunikim publik, duke i bërë më aktiv dhe të zëshëm zyrtarët e saj në publik në avokimin e çështjeve.
- Të lehtësoj komunikimin me qytetar duke vënë një emër të ri të uebfaqes dhe email-it, më të lehtë për t'u mbajtur mend(email-i aktual: ombudspersonkosovo@ombudspersonkosovo.org)
- Të hap një linje online telefonike për shërbime falas për qytetarët që kërkojnë ndihmën e Avokatit të Popullit.

¹ Gazeta Zëri, Avokati i zorit

² Intervistë e Avokatit të Popullit, Sami Kurteshi; Gazeta Zëri.

³ Intervistë e kryetarit të KMDLNJ-së, Behxhet Shala; Shkurt 2010

⁴ Po aty

⁵ Burim anonim. Intervistë, Prishtinë; Nëntor 2010

⁶ Koha Ditore, 23 shkurt 2010

⁷ Intervistë, aktivist i një OJQ-je, Nëntor 2010

⁸ Koha Ditore, 8 dhjetor 2010

⁹ Gazeta Zëri

¹⁰ Hilmi jashari, 27 korrik 2010, Prishtina post

¹¹ Poaty

¹² Raporti i Progresit 2010, fq8. Demokracia dhe Sundimi i Ligjit

*“Duke Mbështetur Qeverisjen e Mirë dhe Qytëtarinë Aktive”
“Supporting Good Governance and Active Citizenry”*



“Andrea Gropa” nr.29, 10000 Prishtinë, Kosovë
Tel.+377(0)44 131 542 | www.levizjafol.org | info@levizjafol.org